

PROGRAMI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR PËR "LEGJISLACION MJEDISOR DHE TË DREJTAT MJEDISORE"

1. Qëllimi i programit:

- Të rrisë njohuritë e pjesmarrësve mbi të drejtat e njeriut dhe problemet mjedisore, si ndikojnë të drejtat e njeriut dhe cilat mundësi ofrohen për reduktimin e efekteve klimatike të padëshiruara
- Të rrisë njohuritë e pjesmarrësve mbi impaktin e biznesit në mjedis, si kompanitë publike apo private ushtrojnë veprimtaritë e tyre në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe përgjegjësitë e tyre karshi ligjit.
- Të pajisë pjesmarrësit me aftësi analizuese mbi kuadrin ligjor normativ për respektimin e standardeve të mbrojtjes së mjedisit, biodiversitetit, natyrës dhe ekosistemeve të tjera, si dhe lidhjen mes legjislacionit dhe hartimit të politikave publike mjedisore, detyrimet pozitive dhe negative të shtetit në marrjen e masave dhe hartimin e politikave mjedisore.

2. Objektivat e programit:

Specializim dhe certifikim mbi mbrojtjen e mjedisit dhe aftësim për të propozuar zgjidhje dhe strategji ligjore në përballjen me sfidat e mjedisit dhe ekosistemeve.

Programi në të drejtën mjedisore, **do të ofrojë njohuri në legjislacionin që rregullon dhe mbron mjedisin, biodiversitetin dhe burimet natyrore.** Pjesmarrësit do të mësojnë të përballen dhe të zgjidhin probleme në kontekstin mjedisor, si ndotjen mjedisore, ndryshimet klimatike, sigurinë ushqimore.

Nga ky kurs pjesmarrësit do të aftësohen në:

- (i) njohjen e kuadrit ligjor kombëtar dhe direktivave ndërkombëtare në fushën e mjedisit;
- (ii) analizimin e nivelit të zbatimit të ligjit në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimit të instrumentave që kufizojnë veprimtaritë dhe cenimin e normave mjedisore;
- (iii) vlerësimin e boshllëqeve ligjore dhe propozimeve të plotësimit të kuadrit ligjorë;
- (iv) lidhjet e kuadrit ligjor me politika publike mjedisore, me të cilat promovohen pjesmarrja qytetare në mbrojtjen e mjedisit;
- (v) realizimin e auditeve dhe kontroleve mbi standardet ligjore të mjedisit;
- (vi) identifikimin e çdo risku potencial mbi keqpërdorimin e natyrës dhe gjendjes mjedisore dhe ekosistemeve, që vijnë nga moszbatimi i ligjit, ose mungesa e legjislacionit.

Konkretisht, programi do ta profesionalizojë pjesmarrësin në këto drejtime kryesore, por jo vetëm:

- Të drejtat e njeriut: Do të analizojë se si ndryshimet klimatike dhe problemet mjedisore ndikojnë të drejtat e njeriut dhe cilat mundësi ofrohen nga ligji për reduktimin e efekteve klimatike të padëshiruara
- Impakti i biznesit në mjedis: Do të analizojë se si dhe nëse insitucionet, kompanitë publike apo private ushtrojnë veprimtaritë e tyre në përputhje me legjislacionin mjedisor.
- Analiza e kuadrit ligjor normativ. Do të analizojë progresin, nevojën për ndryshim dhe plotësim përmes iniciativave ligjore për respektimin e standardeve të

mbrojtjes së mjedisit, biodiversitetit, natyrës dhe ekosistemeve të tjera, si dhe lidhjen mes legjislacionit dhe hartimit të politikave publike mjedisore.

I. PROGRAMI

MODULI 1: HYRJE NË MJEDIS. REGJIMI JURIDIK RREGULLATOR PËR MJEDISIN

- Njohuri mbi konceptet bazë të mjedisit.
- Sfondi dhe historiku i së Drejtës Mjedisore.
- Bazat e së drejtës mjedisore vendase dhe ndërkombëtare. *Soft laws* të mbrojtjes së mjedisit.
- Elementet përbërës të mbrojtjes së mjedisit dhe përcaktimi i burimeve.
- Aksesit i publikut në çështje mjedisore.

MODULI 2: REGJIMI JURIDIK RREGULLATOR PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

- Rreziku i ndryshimeve klimatike. Aktet ndërkombëtare mbi klimën. Veprimet pozitive të shteteve mbi marrjen e masave të detyrueshme mbi ndikimet negative mbi klimën.
- Aspektet substanciale dhe procedurale të luftës kundër ndryshimeve klimatike të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.
- Praktika e proceseve gjyqësore ndërkombëtare në çështjet klimatike.

MODULI 3: ASPEKTET SPECIFIKE SEKTORIALE LIGJORE: BURIMET E RINOVUESHME, MENAXHIMI I UJIT DHE I MBETJEVE URBANE

- Bazat teknike dhe ligjore të Energjisë së Rinovueshme dhe mjedisit.
- Regjimi ligjor i burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme. Teknologjia dhe pastrimi.
- Cilësia e ujit, ndotja dhe mbrojtja ligjore.
- Bazat teknike të shkarkimeve dhe mbetjeve si dhe trajtimi i tyre.
- Regjimi ligjor për mbetjet dhe shkarkimet.
- Fusha ligjore dhe teknike e riciklimit të mbetjeve urbane, niveli i riciklimit dhe problemet në zbatimin e planit të veprimit dhe ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

MODULI 4: STANDARDET KOMBËTARE MJEDISORE. MBROJTJA GJYQËSORE

- Kontrolli kushtetues i të drejtës për mjedis të shëndetshëm, lidhja e saj me të drejtat të tjera. Jurisprudenca kushtetuese dhe e GJEDNJ. **(E drejta kushtetuese)**
- Inspektimet mjedisore. Shkeljet administrative dhe gjykimi i tyre. Praktika administrative dhe gjyqësore dhe sfidat. **(E drejtë administrative)**
- Hetimi i krimeve mjedisore, Lidhja mes krimeve mjedisore, krimi të organizuar dhe pastrimit të parave; praktika gjyqësore. **(E drejtë penale)**.

MODULI 5: ÇËSHTJET MJEDISORE NË LEGJISLACIONIN E BE *(acqui communautaire)*

- Parimi i kujdesit dhe parandalimit të dëmit në çështjet mjedisore.
- Aspekte krahasuese sanksionuese në çështjet mjedisore.
- Përgjegjësia individuale dhe kolektive për dëmtimin e mjedisit.
- Kuadri krahasues ligjor evropian në çështjet penale për dëmet në mjedis.

- Transpozimi i legjislacionit dhe direktivave mjedisore të BE në legjislacionin shqiptar (procesi i përafrimit).

MODULI 6: ANALIZË MBI PROGRESIN E ZBATIMIT TË AKTEVE LIGJORE E NËNLIGJORE NË FUSHËN E MJEDISIT DHE PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË VENDIMMARJE

- Zbatimi nga institucionet në nivel kombëtar, rajonal, lokal dhe agjencitë ligjzbatuese.
- Metodologjia e analizës së zbatimit të ligjit.
- Adresimi i problematikave ligjore për standarde mjedisore të pazbatuara.
- Analiza e zbatimit të legjislacionit në planet e menaxhimit, mbrojtjes së mjedisit, biodiversitetit, mbrojtjes së natyrës dhe ekosistemeve të tjera.

MODULI 7: MBROJTJA E KONSUMATORIT NË ÇËSHTJET MJEDISORE

- Konventat ndërkombëtare mbi të drejtën e sigurisë ushqimore dhe legjislacioni shqiptar.
- Zinxhiri ushqimor dhe prodhimi i produkteve ushqimore me përmbajtje toksike dhe impaktet mbi shëndetin njerëzor.
- Menaxhimi mjedisor i tokës për mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit.
- Mbrojtja ligjore e konsumatorit në gjykatë.

MODULI 8: DEONTOLOGJIA DHE ETIKA NË ÇËSHTJE TË MJEDISIT

- Dilemat aktuale në çështje të mjedisit
- Tregu, konkurrenca dhe mjedisi: marrëveshjet e fshehta, abuzimet dhe përqendrimet
- Zhvillimi ekonomik vs. mbrojtja e mjedisit
- Menaxhimi ligjor i reputacionit për shkak të dëmtimit të mjedisit
- Zhvillimi i politikave publike me të cilat promovohet ndërgjegjësimi mjedisor.

II. KOHËZGJATJA

Kursi zgjat 3 muaj, (23 Shtator – 23 Dhjetor), zhvillohet me pjesmarrje hibride të pjesmarrësve në auditore, për 10 javë kalendarike, sipas kalendarit mësimor.

III. GRAFIKU I MODULEVE

Moduli	Orë Leksion /auditor	Kredite
1. Hyrje në mjedis. Regjimi juridik rregullator për mjedisin	6	1
2. Regjimi juridik rregullator për ndryshimet klimatike	6	1
3. Aspektet specifike sektoriale ligjore: burimet e rinovueshme,	6	1

menaxhimi i ujit dhe i mbetjeve urbane		
4. Standardet kombëtare mjedisore. mbrojtja gjyqësore	6	1
5. Çështjet mjedisore në legjislacionin e BE (<i>acquis communautaire</i>)	6	1
6. Analizë mbi progresin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore në fushën e mjedisit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje	6	1
7. Mbrojtja e konsumatorit në çështjet mjedisore	6	1
8. Deontologjia dhe etika në çështje të mjedisit	6	1
9. Seminar mbi tetë modulet	6	1
10. Detyrë / projekt / prezantim	6	3
TOTAL	60	12

Shënim:

25 orë totale (leksion, seminar + studim individual etj) = 1 kredit ECTS

IV. VLERËSIMI

Komponentët e vlerësimit të kursit

Moduli	Vlerësimi në %
1. Frekuenca	10
2. Angazhimi	10
3. Mini test	80
TOTAL	100

Marzhet e konvertimit të vlerësimeve të grumbulluara gjatë kursit

Vlerësimi i kursit në Notë	Konvertimi i Vlerësimit në %
9 - 10	Shumë mirë
8 - 7	Mirë
6 - 5	Kalues
0 - 4	Jo kalues

V. PAJISJA ME CERTEFIKATË

Pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë, në të cilën vërtetohet dhe pasqyrohet kalimi i kursit prej 60 orësh / 12 kredite ECTS me sukses.

V. TARGET AUDIENCA

Ky kurs i adresohet, politikëbërësve, praktikantëve të ligjit me fokus në çështjet mjedisore, të punësuarve në administratë publike, në Organizata Jofitimprurëse, ose organizma ndërkombëtarë dhe kujdo profesionisti që punon në kompani private, apo çdo lloj sektori, që ka interes në marrjen e njohurive për ndikimin e mjedisit në të drejtat e njeriut.

ANEKS

Lista e institucioneve publike që mund të identifikohen si vatra potenciale për lançim të këtij kursi profesional nga Universiteti POLIS, me profesionistë të interesuar, me

background arsimor në shkenca juridike, ekonomike, sociale, mjedisore, etj, si përfitues të këtij shërbimi, por pa u kufizuar në to, mund të jenë:

- (I) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,
- (II) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,
- (III) Agjencia e Kombëtare e Planifikimit të Territorit,
- (IV) Agjencia e Zhvillimit të Territorit,
- (v) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
- (vi) Inspektoratet vendore të mbrojtjes së territorit
- (VII) Enti Rregullator i Energjisë,
- (VIII) Enti Rregullator i Ujit,
- (IX) Agjencia e Mjedisit,
- (X) Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore,
- (XI) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura me 12 degët në nivel qarku,
- (XII) Agjencia Kombëtare e Turizmit,
- (XIII) Agjencia Kombëtare e Pyjeve,
- (XIV) Agjencia Kombëtare e Bregdetit,
- (XV) Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve,
- (XVI) 61 Bashkitë (Drejtoritë Juridike dhe Drejtoritë e Mjedisit)
- (XVII) Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
- (XVIII) Kontrolli i Lartë i Shtetit
- (XIX) Avokati i Popullit

Miratur nga

Prof. Asoc. Llazar Kumaraku
Dekan
Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban